



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KUVENDI
KOMISIONI PËR POLITIKËN E JASHTME

Dokument parlamentar

RAPORT
(Për dhënie mendimi)

**PËR PROJEKTLIGJIN PËR
“RATIFIKIMIN E MARRËVESHJES NDRYSHUESE
ME SHKËMBIM LETRASH, TË MARRËVESHJES SË ANGAZHIMIT,
NDËRMJET KËSHILLIT TË MINISTRAVE TË REPUBLIKËS SË
SHQIPËRISË, PËRFAQËSUAR NGA MINISTRIA E SHËNDETËSISË
DHE MBROJTJES SOCIALE, DHE ALEANCËS GAVI,
PËR PJESËMARRJEN NË STRUKTURËN GLOBALE TË QASJES
NË VAKSINAT COVID-19 (COVAX FACILITY), MIRATUAR
ME LIGJIN NR.134/2020”**

➤ **HYRJE**

Më datë 18.03.2021 Komisioni për Politikën e Jashtme, në cilësinë e Komisionit për dhënie mendimi, në zbatim të neneve 32-38 të Rregullores së Kuvendit shqyrtoi projektligjin për “Ratifikimin e marrëveshjes ndryshuese me shkëmbim letrash, të marrëveshjes së angazhimit, ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë, përfaqësuar nga Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, dhe Aleancës GAVI, për pjesëmarrjen në strukturën globale të qasjes në vaksinat COVID-19 (Covax Facility), miratuar me ligjin nr.134/2020 propozuar nga Këshilli i Ministrave.

Në mbledhjen e Komisionit për paraqitjen e projektligjit ishte e pranishme znj. Mira Rakacolli, Zëvendësministre e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale.

I. BAZA KUSHTETUESE E PROJEKTLIGJIT

Ky projekt-akt i Këshillit të Ministrave propozohet në mbështetje të neneve 81, pika 1, 83, pika 2, 100 dhe 121, pika 1, shkronja “d”, të Kushtetutës dhe të neneve 12, 17 dhe 23, të ligjit nr.43/2016, “Për marrëveshjet ndërkombëtare në Republikën e Shqipërisë”.

II. QËLLIMI DHE PËRMBAJTJA E PROJEKTLIGJIT

Qëllimi i projektligjit është miratimi i ndryshimeve të marrëveshjes ekzistuese së angazhimit, ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë, përfaqësuar nga Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, dhe Aleancës GAVI, për pjesëmarrjen në strukturën globale të qasjes në vaksinat COVID-19 (COVAX Facility), e cila është miratuar me ligjin nr.134/2020.

III. EFEKTET FINANCIARE

Sa i takon efekteve financiare, sikurse është përcaktuar edhe në relacionin shoqërues, ky projektligj nuk shoqërohet me efekte financiare.

IV. DISKUTIMET NË KOMISION

Znj. Mimi Kodheli, Kryetare e Komisionit, pasi theksoi se Komisioni për Politikën e Jashtme e shqyrton këtë projektligj në cilësinë e Komisionit për dhënie mendimi, në zbatim të neneve 32-38 të Rregullores së Kuvendit, ia dha fjalën znj. Mira Rakacolli, Zëvendësministre e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale

Znj. Rakacolli, bëri prezantimin e projektligjit duke dhënë shpjegimet e nevojshme për ndryshimet e propozuara. Pasi bëri një pasqyrë të situatës së pandemisë dhe procesit të vaksinimeve ajo theksoi se ndryshimet synojnë të përshpejtojnë dhe përmirësojnë procedurat për sigurimin e vaksinave në kontekstin aktual.

Ajo theksoi se Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale ka mbajtur komunikim të vazhdueshëm me përfaqësuesit e Aleancës GAVI dhe është njoftuar se shumica e furnizimeve me vakcina është bërë në kushtet kur vaksinat kanë marrë autorizimin e përdorimit emergjent. Aleanca GAVI ka propozuar që në vend që GAVI të kërkojë heqje dorë sa herë që një furnizues vaksine i ofrohet një pjesëmarrësi, një ndryshim në marrëveshjen aktuale të angazhimit për të rregulluar statusin e autorizimeve të përdorimit emergjent.

Znj. Elona Gjebrea, në cilësinë e relatores, duke falënderuar Zëvendësministren për prezantimin e detajuar, shpjegoi se termi “vaksinë e miratuar” nënkupton një vaksinë kundër COVID-19 në lidhje me të cilën Gavi ka ndërmarrë një angazhim të përparuar të blerjes dhe që ka ose para-kualifikim të OBSH-së, autorizim standard/të kushtëzuar marketingu ose një autorizim për përdorim emergjent të vendosur nga një SRA ose Autorizim Përdorimi Emergjent të OBSH-së.

Më tej ajo vlerësoi rëndësinë e nismës dhe ftoi Komisionin ta miratonin projektligjin.

Znj. Mimi Kodheli, në përfundim të diskutimeve, theksoi se ky ndryshim lejon të përshpejtohet caktimi i vaksinave që kanë marrë autorizimin e përdorimit emergjent në mënyrë që të mos humbet kohë me alokimin e tyre. Ajo shprehu mbështetjen e saj të plotë ndaj nismës dhe ftoi Komisionin për të votuar projektligjin unanimitet.

➤ PËRFUNDIME

Në aspektin ligjor, projektligji është në përputhje me Kushtetutën dhe legjislacionin në fuqi.

Në aspektin procedural, projektligji është paraqitur në përputhje me Rregulloren e Kuvendit.

Në përfundim, Komisioni për Politikën e Jashtme votoi projektligjin në parim, nën për nen dhe në tërësi dhe pasi e miratoi atë me unanimitet u shpreh dakord për kalimin e këtij projektligji për miratim në seancë plenare.

RELATORE

Elona GJEBREA

KRYETARE

Mimi KODHELI